



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:091104

Datë: 28.06.2021

Numri i dokumentit: 01928668

NË EMËR TË POPULLIT

PKR.nr. 101/21

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, duke vendosur sipas kryetarit të trupit gjykues Naser Maliqi, me sekretaren juridike Hykmete Pajaziti, në çështjen penale të pandehurit B. B. nga Fshatati Drobesh, Komuna e Vitise, për shkak vepres penale Mbajtje ne pronesi, kontrole dhe posedim te paautorizuar te armeve nga neni 366 par.1 te KPRK-se, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamentni për Krimet e Rënda, PP/I. nr. 81/2021, e dt. 24.05.2021, e pas mbajtjes e shqyrtimit fillestar me dt. 22.06.2021 shpall dhe përpilon këtë:

AKTGJYKIM

Ndaj te pandehurit;

B. B. nga babai H. dhe nëna D., e lindur L., i lindur më 30.07.1955 ne fshatin Komuna e Gjilanit dhe jeton ne fshatin, Komuna e Vitisë me nr.personal, i gjendjës së varfër ekonomike, ka të kryer dy vite shkollë fillore, i ve baba i gjashtë femijëve, pensionist, shqiptar, shtetas I Republikës së Kosoves.

ËSHTË FAJTOR

Sepse në kohë të papëcaktuar e deri më datë 15.04.2021, ka siguruar dhe mbajtur në pronësi në mënyrë të pa autorizuar armët e zjarra dhe ate: një pushkë automatike Thompson 263834, një pushkë përsëritëse karabinë 11P, një karikator I Thompson, një karikator I AK 47, tri bajoneta, të cilat me dtën e sipërshënuar janë gjetur gjatë bastisjes së shtëpisë së tij në fshatin Drobesh, K. e Vitisë, I janë gjetur dhe I janë konfiskuar përkohësisht nga ana e Policisë së Kosovës.

-me ç'rast ka kryer veprën penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366.par.1.te KPRK-së.

E GJYKON

Me denim me gjobë në lartsi prej **300.00 (treqind) euro**, të cilin denim duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmëris së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ky denim me gjobë do të zëvendsohet me denim burgu, ku për çdo 20 euro do të llogaritet nga një ditë burg.

Detyrohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajën shumën prej nga **20 (njëzet) eurove**, si dhe shpenzimet e procedurës sipas llogarisë perfundimtare.

Konfiskohen armët e zjarra dhe ate: një pushkë automatike Thompson 263834, një pushkë përsëritëse karabiner 11P, një karikator I Thompson, një karikator I AK 47, tri bajoneta.

A R S Y E T I M

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti për Krime të Renda, me dt.24.05.2021, ka ngritur aktakuzën PP.I. nr.81/2021, ndaj të akuzuarit B. B., për shkak veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armeve, nga neni 366.p.1, ka kërkuar që pas shqyrtimit gjyqësor të pandehurin ta shpallë fajtor dhe denoi me denim meritor sipas ligjit.

Kryetari i trupit gjykues, me datën 22.06.2021, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, ku është lexuar aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit dhe pas leximit të aktakuzës i pandehurit, **B. B.**, ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën e lexuar,

e pranon fajsinë lidhur me veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366.par.1.te KPRK-së.

Gjatë shqyrtimit fillestar dhe publik kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të të pandehurit dhe prokurorit të shtetit, ka marr aktvendim me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësisë, për shkak se ky pranim është bërë në mënyrë vullnetare dhe është në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës: raporti i oficerit të Policisë me nr. 2021-CG-0122 date 15.04.2021, fotodokumentacioni nga shkresat e lëndës, procesverbali mbi konfiskimin e armëve të zjarrta, deklarata e të pandehurit.

Kryetari i trupit gjykues ka konstatuar, se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit, pranimi i fajit mbështet në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza dhe se e njëjta nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjatë matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata ka marr për bazë rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Në këtë aspekt kryetari i trupit gjykues si rrethane lehtësuese për të pandehurin ka pas parasysh pranimin e fajësisë, është penduar, ka kërkuar falje për kryerjen e kësaj veprës penale, gjendjen e varfer ekonomike, i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen, nuk do të përsëris vepra tjera penale, moshën e të pandehurit, është pensionist.

Sipas Kryetarit të Trupit Gjykues, dënimi me gjobë I shqiptuar si në dispozitiv të aktgjykimi është adekuat me veprën e kryer nga ana e të pandehurit, i cili dënim do të ndikoj pozitivisht te i pandehuri dhe rrethi i tij shoqëror, që këto vepra të mos përsëriten më.

I pandehuri është detyruar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro, si dhe shpenzimet e procedurës penale në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate.

Gjykata ka konfiskuar armët e zjarrta dhe ato: një pushkë automatike Thompson 263834, një pushkë përseritëse karabiner 11P, një karikator i Thompson, një karikator i AK 47, tri bajoneta .

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
Më datë: 22.06.2021

Sekretare juridike,
Hykmete Pajaziti

Kryetari i trupit gjykues
Naser Maliqi

KSHILLA JURIDIKE: Kunder këtij aktgjykimi, palët e pakënaqura munden të ushtrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.